

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1



I dënuar dhe drejtor burgu tek '313'-a, Ministria e Drejtësisë nis hetimet për Edison Metajn

2



'Pa Gjurmë' gjen pas 27 vitesh në Itali Bukurie Dervishi, shpërthen në lot e bija në studion e Report Tv: Nuk e njoha zërin dhe imazhin e saj

3



Konstituohet Komisioni Hetimor për 25 prillin, raporti final në 12 janar 2022! Kërkesë për informacion në 19 institucione, Rama dhe 21 zyrtarë të tjerë do t'ihirren dëshmitarë! Lista

4



Ruci, uron kryeparlamentaren Çmilytë-Nielsen për festën e pavarësisë: Mirënjohje Lituanisë evropian të Shqipërisë

5



Gazetari bjellorus Protasevich dhe partnerja e tij zhvendosen në arrest shtëpiak

Kronikë

I gjendet arsenal armësh, jelekë dhe kapele policie në banesë, shpallet në kërkim 30-vjeçari në Vlorë

Policia e Vlorës ka shpallur në kërkim një 30-vjeçar për armëmbajtje pa leje. Gjatë kontrollit të ushtrua në banesën e Adem Aliaj (Idrizaj), 30 vjeç, në fshatin Mallkeq, policia ka gjetur të fshehur një arsenal armësh



[Sh].com

Redaksia

10 Tetor, 16:22 | Përditësimi i fundit: 10 Tetor, 16:34

WhatsApp

A

A

VLORE– Policia e Vlorës ka shpallur në kërkim një 30-vjeçar për armëmbajtje pa leje. Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit Adem Aliaj (Idrizaj), 30 vjeç, në fshatin Mallkeq, policia ka gjetur të fshehur një arsenal armësh. Policia gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provës materiale 2 armë zjarri automatik, njëra me silenciator, 1 armë zjarri pistoletë, 6 karikatorë me fishekë, 2 jelek dhe 2 kapele si të Policisë.

'Kontrollet nga seksioni për Hetimin e Narkotikëve në bashkëpunim me Forcën e Posaçme Operacionale në DVP Vlorë dhe shërbimet e Patrullës së Përgjithshme në Komisariatin e Policisë Vlorë.Si rezultat i kontroleve, u sekuestruan 2 armë zjarri automatik, njëra me silenciator, 1 armë zjarri pistoletë, municion luftarak e veshje si të Policisë.

[Sh].com

LEXO EDHE:



Prerje 500-she, 'tufa' e parave që iu gjetën në shtëpi ish-drejtorit të Kadastrës së Vlorës! U arrestua si pjesë e grupit që falsifikonin dokumentet e pronave në Dhërmi e Himarë

Shpallet në kërkim poseduesi i tyre dhe vijon puna intesive për kapjen e tij. Në vijim të punës për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje, si rezultat i kontroleve të shtuara për rritjen e parametrave të sigurisë dhe parandalimin e ngjarjeve të mundshme kriminale, bazuar dhe në informacionet që Seksioni për Hetimin e Narkotikëve dispononte, në bashkëpunim me Forcën e Posaçme Operacionale, kanë ushtruar kontroll në banesën e shtetasit A. A, në fshatin Mallkeq, Vlorë.

Gjatë kontrollit në banesën e tij, Policia gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provës materiale 2 armë zjarri automatik, njëra me silenciator, 1 armë zjarri pistoletë, 6 karikatorë me fishekë, 2 jelek dhe 2 kapele si të Policisë.

Në vijim të veprimeve specialistë të Seksionit për Hetimin e Trafiqeve dhe Narkotikëve në DVP Vlorë, shpallën në kërkim shtetasin A. A. alias A. I., 30 vjeç, banues në fshatin Mallkeq, Vlorë.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Vlorë për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit" dhe "Mbajtja pa të drejtë e uniformës".- njofton policia.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG:

Vlore

policia

arsenal armesh

adem aliaj idrizi

 Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:
A ju duket e drejtë që studentët e pavaksinuar të frekuentojnë auditorët duke rrezikuar shëndetin e të tjerëve?

PO

JO

NUK KAM MENDIM

Komento

Komente

Dukati:

10/10/2021 16:48

Ushitari i armando arixhiut

Përgjigju

Lajme të tjera

Sociale



U kërkohet vaksinë anti-COVID ose test PCR, studentët në Vlorë nuk lejohen të futen në auditorë

18 Tetor, 08:44

Sociale



Manastiri i Zvërnecit atraksion turistik në vjeshtë, të huajt: Do vijmë sërish! Shqiptarët: Duhet investim

17 Tetor, 22:01

Kronikë



Pjesë e grupit që falsifikonin dokumentet e pronave në Dhërmi e Himarë,arrestohet ish-kreu i Kadastrës së Vlorës që u dorëhoq disa ditë më parë! Iu gjetën 65 mijë euro në banesë

17 Tetor, 19:41

Kronikë



Falsifikuan dokumentet e pronave në Dhërmi dhe inskenuan vjedhjen e dosjeve, burg për Bardhyl Gjikën dhe Spiro Dunin, lihet i lirë specialisti

17 Tetor, 09:42

Sociale



Nga Brindisi mbërrijnë në Vlorë 3 veliera me ndihma nga Italia për shtëpinë e fëmijëve jetimë në qytet

16 Tetor, 19:51

Politikë



PD: Qeveria mban mbyllur godinën e re për shkollat e Sarandës, Eco Kampus, pasojat i vuajnë fëmijët

16 Tetor, 14:14